

Investimi i nisur ne plazhin e Velipojes me ndertimin e Velipoja “Grand Europa” Resort nga kompania Xhenis Sh.p.k eshte vleresuar nga ana e zyrtareve te larte te pranishem ne ceremonine e inagurimit te nisjes se punimeve, si fryma e re qe ka nisur te fryje ne Velipoje. Zv/ministria e Arsimit dhe Shkences Nora Malaj duke e cilesuar kete investim si nje garanci per suksesin e turizmit shqiptar, tha se ky resort do te jete edhe nje mundesi e mire punesimi per zonen, duke ndikuar ne zhvillimin ekonomik. Ne te njejten linje, edhe zv/ ministri i ekonomise Sokol Dervishi ne prononcimin e tij per tv1 channel tha se me kete investim te Xhenis SH.P.K, Velipoja dhe Shqiperia krijojne nje imazh ndryshe per turizmin, tashme ate elitar. Ne aspektin turistik dhe kulturor, zv/ministri i Turizmit, Kultures Rinise dhe Sporteve Abaz Hado pranon se me kete investim Shqiperia konkuron fuqishem vendet e rajonit dhe do te kthehet ne faktor vendimtar per turizmin ne Ballkan. Edhe kreu i zyres se mbrojtjes se konsumatorit Altin Goxhaj, vleresoi investimin ne fjale duke shtuar se ai mbron me se miri konsumatorin dhe permbush pritshmerite e ketij te fundit. Ndryshe nga cdo investim tjeter, Velipoja “Grand Europa Resort” nuk prek asnje pellembe te gjelberimit te zones, por perkundrazi eshte nje nder projektet qe mbron natyren dhe rrit gjelberimin e zones.